



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 22.02.2021	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojce
01	104/02-5465	1.

Raporti vjetor 2020

Ekzekutivi i Komunës

Tel 038 200 46400

Rr. Qamil Ilazi 71000, Kaçanik

www.kk.rks-gov.net/kacanik

Përmbajtja

FJALA E KRYETARIT	iii
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	1
Qendra për Shërbime me Qytetar	1
Zyra komunale e gjendjes civile	2
Arkivi	3
Njësia komunale për të drejtat e njeriut	4
Mirëmbajtja e objektit dhe autoparku	4
Angazhime tjera të drejtorisë	5
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	7
Qendra për Punë Sociale	8
DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	11
Organizimi i vitit shkollor në përputhje me kushtet epidemiologjike në vend	11
Menaxhimi i pandemisë COVID 19	11
Masat e ndërmarra anti-COVID	12
Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor	12
Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim	13
Vlerësimi i njohurive të nxënësve	13
Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm- Testi i Maturës	14
Trajnimi i mësimitdhënësve sipas fushave kurrikulare	14
Funksionimi i organeve të shkollës	14
Investimet në infrastrukturën shkollore	15
Shënimi i datave të rëndësishme për rininë dhe organizimi i aktiviteteve kulturore	16
DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT	18
Sektori i Buxhetit	18

Sektori i Pagesave	21
Sektori i Tatimit në Pronë	21
Sektori i Zhvillimit Ekonomik	23
DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	26
Sektori i kadastrit	27
DREJTORIA E EMERGJENCAVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE	31
Ujësjiellësi	32
Kanalizimet	33
Ujërat sipërfaqësore	34
Menaxhimi i Mbeturinave	34
Komunikacioni Rrugor	35
Hapësirat Publike	36
Ndriçimi Publik	38
Mirëmbajtja e rrugëve lokale	40
Sektori i Emergjencave	43
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	46
Shqyrtimi i kërkesave, mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti komunës	46
Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale	47
Bashkëpunimi me MBPZHR dhe OJQ-ve	48
Organizimi në mbrojtjen e pyjeve nga prerja ilegale	48
Monitorimi i operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore	49
Pranimi dhe vendosja e kërkesave të pronarëve për pyjet private	49

FJALA E KRYETARIT

Të nderuar qytetar të Komunës së Kaçanikut;

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut;

Viti 2020, si asnjëherë më parë, do të mbahet mend si vit sfidues për të gjithë shoqërinë globale duke përfshirë edhe Kosovën. Arsyeja e mbajtjes mend të vitit që lamë pas është pandemia globale e shkaktuar nga një koronavirus, i cili mori shumë jetë njerëzish si dhe shkaktoi dëme të pariparueshme për ekonominë globale.

Nisur nga kjo, me shfaqjen e këtij virusi pandemik në mars të 2020, e gjithë struktura organizative e punës në komunë ndryshoi drastikisht. Këto ndryshime, erdhën si rrjedhojë e masave strikte që kufizonin lëvizjen e lirë nga qeveria e Kosovës, si dhe një sërë masash tjera plotësuese që në njëfarë forme paralizonin ushtrimin e funksionit të mirëfilltë administrativ të komunës.

Me të parë situatën që zhvillohej në terren, Komuna e Kaçanikut ka mbështetur fuqishëm masat e qeverisë si dhe rekomandimet e IKSHPK-së dhe ka themeluar shtabin komunal për këtë çështje dhe mekanizma tjerë të nevojshëm.

Sidoqoftë, ky fakt i ri, përveç që ka prekur qytetarët tanë, ka prekur edhe institucionet duke vështirësuar tej mase funksionimin normal dhe arritjes së objektivave. Nga kjo lirisht mund të themi se pa dashje pandemia ka ndikuar shumë që të realizohet plani 100% nga Komuna e Kaçanikut.

Viti 2020 ishte një vit me shumë specifika, që na ndryshoi rrjedhën e jetesës të gjithëve, pa dallime. Ishte një vit më ndryshe se që jemi mësuar ta jetojmë, një vit më sfida të reja. Raporti një vjeçar i punës së ekzekutivit, paraqet të gjitha aktivitetet dhe punët e realizuara gjatë vitit 2020, të cilat ishin të varura nga zhvillimet me situatën nga pandemia COVID 19. Situata me pandemi, ka prekur sidomos projektet dhe aktivitetet kulturore e sportive, të cilat nuk kanë mundur të realizohen në 2020-tën.

Me gjithë vështirësitë me të cilat u përballë bota në menaxhimin e pandemisë, punët dhe aktivitetet komunale nuk janë ndalur. Investimet në projektet e ndryshme infrastrukturore, kanë vazhduar sipas planifikimeve buxhetore. Së

bashku me stafin e përkushtuar komunal, kanë përfunduar disa projekte madhore, të cilat kanë pasur prioritet në qeverisjen time komunale.

Ndërsa kemi vazhduar punën dhe përkushtimin tonë komunal me integritet të lartë moral e profesional, duke arritur të përmbyllim projektet kapitale, shpenzimin në afat dhe korrekt të buxhetit komunal, përfitimin nga granti i performancës, transparencë të plotë në vendimmarrje si dhe ofrim të shërbimeve cilësore komunale.

Përmes programit qeverisës komunal, edhe në vitin 2020 janë përfshirë të gjitha fushat në procesin e avancimit, përmes projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

Z. Besim Hazi


DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Qendra për Shërbime me Qytetar

Natyrisht se misioni i DAP është "përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve nëpërmjet komunikimit korrekt dhe transparent lidhur me kushtet, procedurat administrative, respektimin e ligjeve, respektimin e afateve kohore të dhënies së përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve etj". Të gjitha këto detyra që paraqiten në misionin e drejtorisë synohen që të arrihen nëpërmjet Qendrës Komunale për Shërbime me Qytetar. Përkundër vështirësive që janë paraqitur në hyrje të këtij raporti, QKSHQ ka arritur që nëpërmjet zyrtarëve të saj t'i arrijë objektivat.

Gjatë vitit 2020, janë pranuar dhe proceduar 32681 lëndë, vetëm 426 prej tyre kanë ngelur në proces. Krahasuar me vitin paraprak vërehet rënie e lëndëve për 8441 më pak.

Përshkrimi	Pranuar	Në Proces	Miratuar	Refuzuar	Përfunduar	Totali
Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	33	2	2292	1	13197	15531
Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës	62	54	737	211	0	1279
Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë	13	4	794	21	0	980
Drejtorja e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit	14	15	6449	5	0	6485
Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	30	44	349	15	0	445
Drejtorja e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike	44	9	416	57	0	530
Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	51	232	5587	10	0	5898
Shërbimi i Kryetarit	107	66	1168	180	0	1533
	354	426	17792	620	13197	32681

Tab 1. Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes prej 01/01/2020 – 31/12/2020.

Përkundër numrit më të vogël të lëndëve në vitin për të cilin raportojmë, në krahasim me vitin 2019, ka ngjitje të performancës në raport të përfundimit të lëndëve në kohë për 1.37%. Trajtimi i lëndëve për vitin 2020 shënon rritje dhe në total është 98.70%.

Zyra komunale e gjendjes civile

Si të gjithë sektorët tjerë, njashtu edhe ZKGJC është prekur nga pandemia duke pamundësuar punën ashtu siç duhet. Megjithatë për vitin 2020, ky sektor ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë në sajë të autorizimeve ligjore si në vijim:

Përshkrimi	Copë
Ekstrakte të Lindjes	15977
Certifikata të Lindjes	6416
Certifikata e Martesës	4227
Certifikata e Vdekjes	1241
Certifikata e Gjendjes Martesore	814
Deklarata Familjare	3678
Certifikata e Vendbanimit	1297
Certifikata e Shtetësisë	517
Vërtetime të Arkivit	1199
Dëshmi Vdekje	78
Totali: 35295	

Tab 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01/01/2019-31/12/2019.

Përshkrimi	Copë
Regjistrime të Lindjes të Rregullta	3
Regjistrime të Lindjes të Veçanta	135
Shpallje të martesave	214
Kurorëzime	214
Kurorëzime speciale	57
Regjistrime të vdekjes të rregullta	132
Regjistrime të vdekjes speciale	23
Vdekje pa Akt Lindje me Vendime të Gjykatës	15
Lëndë të kompletuara për fitim të shtetësisë	10
Lëndë të kompletuara për humbje të shtetësisë	26
Vendime të ndryshme	83

Tab. 3. Numri i akteve të lëshuara nga data 01/01/2020-31/12/2020.

Në kuadër të punës të ZKGJC janë përgatitur statistikat mujore dhe janë dërguar me kohë në Agjencionin e Statistikave të Kosovës si dhe të gjitha gabimet për përmirësim janë dërguar me kohë në ARC.

Janë mbajtur takime në lidhje me problemet dhe vështirësitë e ndryshme që përcjellin punën e përditshme të kësaj zyre. Njashtu janë bërë vizita në terren përveç kohës së masave strikte me ç'rast zyrat janë mbyllur por shërbimet nuk janë ndaluar asnjëherë.

Arkivi

Gjatë vitit 2020, Sektori i Arkivit ka punuar dhe është angazhuar me punimin, rregullimin, klasifikimin, sistemimin e lëndëve arkivore sipas njësisë organizative. Gjithashtu është bërë valorizimi regjistrimi (përzgjedhja) e lëndëve arkivore me afate të ruajtjes prej vitit 1946-1965.

Materialeve të cilave ju ka kaluar afati dhe si të tilla nuk e kanë cilësinë e lëndës arkivore janë asgjësuar për të cilat është hartuar procesverbali për asgjësim.

Gjithashtu është bërë hartimi i Librit Arkivor të Këshillit Popullor: Kaçanik, Hani i Elezit, Ivajë, Sllatinë, Kaçanik i Vjetër dhe qytetit prej 1946-1960 dhe Kuvendi Komunal Kaçanik 1960-1998.

Është bërë shqyrtimi i kërkesave, llogaritja e stazhit pensional, plotësimin e formularit M4 si dhe vërtetime të ndryshme.

Asgjësimin e dokumentacionit të cilit i ka kaluar afati dhe si të tilla nuk e kanë cilësinë e lëndës arkivore si në vijim: kërkesa të refuzuara, dublikatë, raporte mujore, ankesa, kërkesa për ndihma momentale, ftesat e ndryshme, materiale hargjuese, vërtetime, vendime për pagesat e udhëtimeve etj. Sipas kërkesave të zyrtarëve komunal dhe palëve, kemi bërë hulumtimin për gjetjen e dokumentacioneve të kërkuara dhe kthimin e tyre në vendin përkatës.

Kopjet e pasaportave lëshuar para vitit 1999 – Sistemimin dhe klasifikimin në bazë të mbiemrave të cilat i kemi vendosur në paketa, në mungesë të kartotekave të cilat janë të dedikuara për vendosjen e tyre. Nga zyrtarët e drejtorive të komunës dhe përfaqësuesit ligjor janë parashtruar 153 kërkesa verbale për gjetjen e lëndëve dhe projekteve arkivore, të njejtat janë kthyer duke i vendosur në vendin përkatës. Janë parashtruar: 51 kërkesa , 10 për vërtetime dhe llogaritje të stazhit pensional të punës (plotësimi i formularit M4). Gjithsej: 61 kërkesa .

Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Parim i NJKDNJ-së është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi me standardet ndërkombëtare në nivel komunal si dhe takimet e rregullta me avokatin e popullit si dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare të cilat kontribuojnë në çështjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Megjithëkëtë, aktiviteti i kësaj zyre për vitin 2020 është reduktuar shumë duke bërë që mos të arrihen objektivat e parapara me planin e punës. Shkak kryesor është pandemia e cila e ka prekur më së shumti këtë sektor.

Mirëmbajtja e objektit dhe autoparku

Gjatë vitit 2020, DAP nëpërmjet sektorit teknik, është përkujdesur për higjienën, pastërtinë, mirëmbajtjen e nxemjes, mirëmbajtjen e aseteve tjera etj. Ky sektor ka kontribuar në vendosjen e dezinfektueseve në zona të caktuara në komunë etj.

Veturat zyrtare kanë qenë në dispozicion për të gjithë zyrtarët publik përgjatë vitit. Këtu përfshihet edhe dalja në gatishmëri për shpërndarjen e pakove ushqimore ku janë ndihmuar familjet në nevojë nëpërmjet vullnetarëve dhe organizatave tjera me dy vetura.

Gjithashtu si rrjedhojë e vullnetit për t'i tejkaluar vështirësitë në terren, me vetura zyrtare të komunës është ndihmuar Policia e Kosovës- Stacioni Policor në Kaçanik.

Për nga funksionimit i duhur i logjistikës të komunës, sektori i autoparkut është kryesori. Rëndësia e saj dëshmohet se për t'i mbikëqyrur projektet kapitale,

duhet që menaxherët ti përcjellin ata nga afër dhe kështu eliminohet mundësia që këto projekte kapitale të cilat i menaxhon komuna të dalin jashtë kontrollit.

Edhe këtë vit për të cilin raportojmë janë përmbushur të gjitha kërkesat për udhëtime brenda territorit të Kosovës nga shërbyesit civil, asambleistët si dhe përfaqësues të OJQ-ve të cilët iu kanë drejtuar drejtorisë të DAP. Në këtë formë, i kemi kontribuar rritjes së performancës të punëtorët dhe njëkohësisht ofrimit të shërbimeve të duhura.

Angazhime tjera të drejtorisë

Drejtoria e Administratës në suaza të përgjegjësi dhe autorizimeve ligjore, ka asistuar në forma të ndryshme në menaxhimin komunal të sëmundjes COVID-19. Në këtë drejtim, janë marrë masat që të menaxhohet dhe reduktohet stafi i zyrtarëve publik, t'i jepet pushim personave me sëmundje kronike si dhe atyre mbi moshën 60 vjeçare.

Gjithashtu kjo drejtori, pas rekomandimit nga shtabi komunal, ka përgatitur lejet e qarkullimit që më pas të njëjtat iu janë shpërndarë qytetarëve.

Edhe pse ishin masat në fuqi kundër pandemisë COVID-19, DAP ka hartuar dhe ka dërguar në kuvend 4 rregullore duke i përfillur të gjitha hapat ligjor të nevojshëm.

Rregulloret në fjalë janë:


1. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01 Nr. 60/01-36408/19;
2. Rregullorja për Taksat Komunale/ Lënda: 01Nr. 60/01-4863/20;

Rregullore për taksat komunale, e harmonizuar në bazë të komenteve të MPB / Lënda: 01Nr. 02-60/01-4863/20;

3. Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës/ Lënda: 01Nr. 02- 104/02-26493/2

4. Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës/ Lënda: 01Nr. 04-610/01-30862/20.

Gjithashtu DAP është përkujdesur që zyrtarëve publik t'iu ofrohen kushtet optimale për punë. Për këtë, është realizuar projekti për furnizimin dhe montimin e skanerit digjital si dhe furnizimin me kompjuterë e pajisje tjera të nevojshme.



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale gjatë periudhës janar - Dhjetor 2020 ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të ngritet cilësia dhe efikasiteti në shërbimet primare shëndetësore, shërbimet sociale dhe shërbimet e inspektimit sanitar. Ky raport përfshinë pjesën kryesore të aktiviteteve që janë realizuar gjatë këtij viti. Gjatë vitit 2020 në kuadër të DSHMS-së janë ndihmuar 72 familje, ku janë përfshirë vetëm ndihmat financiare.

Gjatë kësaj periudhe kemi pas bashkëpunim me shumë shoqata të ndryshme që kanë ndihmuar familjet skamnore për kohë pandemie gjithashtu edhe nga shëndetësia kemi pas ndihma të ndryshme nga donator të ndryshëm

Në bashkëpunim me ekipin e Zyrës Ndërlidhëse Monitoruese të KFOR-it Polak, kemi bërë kërkesë për një mjet transportues për HENDIKOS ku kemi marr konfirmim se kemi fitu donacionin. Gjatë këtij viti janë lëshuar vendime dhe vërtetime të ndryshme që i përkasin kësaj drejtorie.

Është bërë renovimi i disa QMF-ve dhe AMF-ve në teren. Gjithashtu gjatë këtij viti është blerë edhe një autoambulancë për QKMF dhe disa pajisje për laborator dhe aparati i rëntgenit.

Gjatë kësaj periudhe të Pandemisë COVID19 Komuna e Kaçanikut në bashkëpunim me organizata të ndryshme dhe individ të ndryshëm kanë pranuar dhe janë shpërndarë: 2365 Pako Ushqimore, 62.875 kg Miell dhe 390 Pako Higjienike.

Bashkëpunime të tjera nga shëndetësia kemi pas si me KFOR-in italian ku kemi pranuar një EKG 12 kanalesh, aparate për matjen e tensionit arterial, sfingomanometra, inhalatorë për të rritur, inhalator për fëmijë, pulsoksimetra, termometra manual, termometra digjital.

Kompania farmaceutike "JONAMED " nga Prishtina ka dhuruar barna për fëmijë në vlerë prej 1.950,00 €. UNICEF-i ka dhuruar 2 herë gjatë vitit 2020 për QKMF-në material higjienik ,si dhe mjete mbrojtëse personale.

Vlen të theksohet se kemi pranuar donacione nga organizata dhe individë të vullnetit të mirë kryesisht mjete mbrojtëse për punëtorët shëndetësor.

Qendra për Punë Sociale

Gjatë vitit 2020 Shërbimi profesional i Qendrës për Punë Sociale në Kaçanik, është angazhuar në realizimin e programit të punës duke punuar në të gjitha format që kanë të bëjnë me Mbrojtjen Sociale. Gjatë kësaj kohe, kemi zbatuar tërë legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Shërbimin Social.

Fëmijët pa kujdes prindëror:

- Fëmijët pa dy prindër;
- Fëmijët e braktisur;
- Prindërit e fëmijëve që nuk i kryejnë detyrat prindërore.

FËMIJËT PAKUJDE PRINDOR	NR. I FËMIJËVE/ MUJORI 2020	PËRZGJEDHJA E FAMILJES	KUJDESTARI	STREHIMI I PËRKOSHËM	STREHIMI FAMILJAR	ADOPTIMI	REFERENCA NË INSTITUCIONET TJERA	PREGADITJA E STREHIMIT	PËRCJELLJA E FËMIJËVE NËN PËRKUJDESJE	RASJET NË PROCES	TË MBYLLURA	TOTAL
FËMIJËT PA DY PRIND	9	po	9	po	po	jo	jo	-	Të gjithë fëmijët janë përcjellur	1		9
FËMIJËT E BRAKTISUR	1	jo	po	-	jo	jo	Në gjyaktë	-		1		1
PRINDËRIT E FËMIJËVE QË NUK I KRYEJN OBLIGIMET	10	PO				-	PO	-	PO	5	5	10

Tab. Nr. 4.

Nga tabela e lartshënuar konstatojmë këtë:

Fëmijë të braktisur: gjatë vitit 2020 kemi pasur një fëmijë të braktisur i cili edhe sot është në proces të Gjykatës për adoptim.

Prindërit e fëmijëve të cilët nuk i kanë kryer detyrat prindërore:

Fëmijët e familjeve në konflikt me ligjin:

- Keqtrajtimi i fëmijëve dhe lënia pas dore;
- Fëmijët e familjeve me marrëdhënie të çrregulluara;
- Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar.

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar edhe me prindërit të cilët nuk kanë pasur kujdes ndaj fëmijëve të tyre.

FËMIJËT E FAMILJEVE NË KONFLIKT	NDËR MJET ËSIMI	STREHIMI I PËRKOHËSHË M I FËMIJËVE	INICIMI I PROCEDURA VE PËR MARRJEN E TË DREJTËS PRINDORE	CAKTIMI I KUJDEST ARIT	BASHKË PUNIMI ME INSTITU CIONET TJERA	RASTE NË PROCE S	TË MBYLLURA
A) KEQËTRAJTIMI DHE LËNJA PAS DORE	3	-	1	-	po	3	1
B) FËMIJËT E FAMILJEVE ME MARRËDHËNJE TË ÇRREGULLUARA	11	-	-	-	PO	5	6

Tab. Nr. 5.

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar edhe me prindërit të cilët nuk kanë pasur kujdes ndaj fëmijëve të tyre.

Zyrtarët e Shërbimit Social janë marrë me përkujdesjen dhe përcjelljen e rastit, fëmijët janë vizituar dhe është biseduar me prindërit e tyre. Më lartë (tab.5) kemi paraqitur tabelë e kësaj forme të Mbrojtjes Sociale.

Në këtë periudhë kohore jemi ballafaquar edhe me problemin e fëmijëve të familjeve me çrregullime bashkëshortore ku ky numër i fëmijëve arrin në 11. Ndërsa, në trajtim të QPS, nga Zyrtarët e Shërbimit Social këtyre fëmijëve iu

është dhënë mendimi për besueshmërinë e njërit prind i cili ka aftësi për tu kujdesur për rritjen dhe zhvillimin normal të cilat janë kërkuar nga gjykata.

Fëmijet dhe rinia me sjellje të çrregulluar	Puna me familje dhe fëmijë	Bashkëpunimi me shkollë	Me policij	Me gjyq	Me OJQ	Propozimi i masës educative dhe alternative	Përcjellja e masës educative dhe alternative	Rastet në proces të rij / të vetër	Të mbyllur	Total
a) Fëmijët me sjellje asociale të mosh. 14	3	3	po	po	po	3	po	3	3	6
b) Rinia me sjellje asociale 14-18	5	2	-	po	po	-	-	-	-	7
Delikuentët e ri prej 14-16 v.	Për vitin 2020	po	po	po		po	po		po	30
Delekkuentët e rritur 16-18	35	po	po	30		po	po		po	35

Tab. Nr. 6. Fëmijët dhe rinia me sjellje të çrregulluara.

Prej këtij numri të 65 delikuentëve, 20 kanë kryer vepra penale, 35 kanë kryer vepra kundërvajtëse. Struktura gjinore e tyre është 62 meshkuj dhe 3 femra. Nga ky numër i delikuentëve kemi 12 përsëritës të veprave (Recidivistë). Masa të shqiptuara ndaj këtyre delikuentëve kemi : 20 delikuent kanë masën edukative- Kujdesi i shtuar prindëror, 6 delikuent kanë masën - Kujdesin e shtuar të Organit të Kujdestarisë dhe 7 delikuent me masën punë me interes publik. Të tjerat janë në procese të gjykatave. Në rastet e delikuentëve zyrtarët e Shërbimit Social kanë marr pjesë gjatë intervistimit nga ana Policisë së Kosovës në Kaçanik në 35 raste në kohë të ndryshme.

Strehimi në strehimore:

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 2 raste të strehuara në strehimore në Ferizaj. Gjinia e tyre ka qenë femra të cilat kanë pasur dhunë në familje por edhe nga personat jashtë familjes. Qëndrimi tyre ka qenë prej një dite deri në tri ditë.

DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Organizimi i vitit shkollor në përputhje me kushtet epidemiologjike në vend

Shpërthimi i pandemisë së koronavirusit (COVID-19) në fillim të vitit 2020, në vendin tonë, krijoi një situatë të re edhe në sistemin arsimor, ndërsa autoritet e shëndetit publik në bashkëpunim edhe me institucionet arsimore kanë ndërmarr një varg masash mbrojtëse anti COVID 19.

Prioritet gjatë periudhës së pandemisë ishte ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, mësimdhënësve e stafit të shkollave, mirëqenies shëndetësore të tyre si dhe realizimi i procesit edukativo arsimor sipas kornizës së kurikulës së Kosovës, kurrikulave bërthamë për nivelet e arsimit parauniversitar, dhe zbatimin e plan-programeve mësimore.

Të gjitha institucionet arsimore kanë funksionuar sipas skenarit A, pra me prani fizike në shkollë me përjashtim të 2 Shkollave të Mesme të Larta që për një periudhë dy javore, të dyja shkollat, kanë zhvilluar procesin mësimor online/nga distanca, sipas skenarit C.

Menaxhimi i pandemisë COVID 19

Në të gjitha shkollat janë marr masat për ngritjen e nivelit të pastërtisë e higjienës së përgjithshme në objektet shkollore, ndërkaq është bërë edhe dezinfektimi i të gjitha objekteve. Dezinfektimi është bërë për çdo fundjavë nga stafi ndihmës i shkollave, ndërsa për çdo muaj ka vazhduar të bëhet dezinfektimi i tërësishëm. Po ashtu, shkollat janë furnizuar me mjete higjienike si dezinfektues, sapun, e detergjente të tjerë, ndërkaq për secilën shkollë janë siguruar edhe maska mbrojtëse e termometra digjital për matjen e temperaturës për nxënës. Për të ndihmuar fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021, MASH ka publikuar një dokument (Udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimin në kushte të pandemisë COVID 19).

Edhe përkundër zbatimit të të gjitha masave anti COVID 19, megjithatë nuk kanë mbetur të paprekur nxënësit e as mësimdhënësit e punonjësit tjerë arsimor në Komunën e Kaçanikut. Numri i të infektuar me SARS-CoV-2, që nga fillimi i vitit të ri shkollor 2020-2021, ishte gjithsej 21 mësimdhënës, 5 punonjës tjerë arsimor dhe 5 nxënës.

Masat e ndërmarra anti-COVID

Respektimi i Udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimi në kushte të pandemisë COVID 19, sipas skenarëve A dhe B dhe C, themelimi i Task Forcës në nivel shkolle e Komune e duke vepruar në përputhje me udhëzimet e MASH e MSh, përgatitja e hapësirave e dhomave mësimore për numër të përgjysmuar të nxënësve, për klasat me numër të madh nxënësish duke vendosur një nxënës në një bankë e po ashtu edhe shenjëzimi i hapësirave në korridore e hapësira të jashtme, ishin disa nga masat anti COVID.

Parandalimi i përhapjes së virusit, përkatësisht respektimi i plotë i masave mbrojtëse anti COVID për mirëqenien , mbrojtjen, sigurinë dhe ruajtjen e shëndetit të nxënësve dhe stafit tjetër në institucione arsimore.

Si rezultatet i kësaj, procesi mësimor është zhvilluar sipas skenarit A - me praninë fizike në shkollë, ndërkohë vetëm për një periudhë dy javore, dy shkollat e mesme procesin mësimor e zhvilluan sipas skenarit C/online, nga shtëpia dhe atë ShMP "Feiz Guri dhe vëllezërit Çaka" nga 19.11.2020 - 30.11.2020, e Gjmnazi "Skënderbeu" nga 23.11.2020 - 04.12.2020.

Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor

Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor, duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta;

respektivisht gjithëpërfshirja që mundëson mbështetje për të gjithë nxënësit pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale etj. Gjithëpërfshirja ishte prioritet dhe synim për përfshirjen e gjithë nxënësve/fëmijëve në procesin edukativ arsimor, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta.

Në këtë mënyrë, në institucionet tona arsimore është arrit shkallë e kënaqshme e gjithëpërfshirjes së fëmijëve duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta, ndërkohë që pjesëmarrja/përfshirja e tyre duke mësuar së bashku me të tjerët e duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët dhe duke ndarë të njëjtat përvoja të të nxënësve ka qenë vlerë e njëkohësisht edhe proces që ka ndihmuar fëmijët të njohin, pranojnë e vlerësojnë veten. Ndryshe, gjithëpërfshirja është e drejtë e çdo fëmije të ndjehet i respektuar, i sigurt, i mbrojtur dhe të zhvillojë plotësisht potencialin e vet.

Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim

Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim mbetet prioritet, bashkë me ngritjen e kapaciteteve të mësimit dhe nxënies por edhe përgjegjësisë në punë. Zbatimi i reformave në mësimit dhe nxënies, me theks të veçantë zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Parauniversitar) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë, i kanë kontribuar në masë të konsiderueshme përmirësimit dhe avancimit të cilësisë, mësimit dhe nxënies. Investimet në objektet shkollore

Vlerësimi i njohurive të nxënësve

Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, vlerësimi i bazuar në rezultatet e të nxënësve dhe reflektimi i performancës së nxënësve, respektivisht vlerësimi i nxënësve gjatë mësimit në distancë në kohë pandemie COVID 19. Janë zbatuar standardet, respektivisht ka vazhduar vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas kurrikulës së re i bazuar në rezultatet e të nxënësve për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore.

Vlerësimi i nxënësve sipas kërkesave kurrikulare është bazuar në rezultatet e të nxënësve për kompetenca (RNK), rezultatet

e të nxënësve për fushë kurrikulare (RNF) dhe rezultatet e të nxënësve për lëndë mësimore (RNL). Sipas Kornizës Kurrikulare qëllimi kryesor i vlerësimit është mbështetja e të nxënësve dhe arritjet individuale të nxënësve, ndërsa

Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë ka ofruar zgjidhje për vlerësimin e nxënësve në kushte pandemie.

Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm- Testi i Maturës

Në afatin e parë (i shtyrë për shkak të pandemisë) të mbajtur më 29 gusht (duke i respektuar maksimalisht masat mbrojtëse anti COVID 19) i janë nënshtruar gjithsej 357 maturantë të dy shkollave të mesme të larta. Në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 230 xënës maturant të cilët i janë nënshtruar provimit, rezultat pozitiv kanë treguar 173 prej tyre apo 75.21 %. Ndërkaq, në SHMP nga gjithsej 127 nxënës maturant të cilët i janë nënshtruar provimit , atë e kanë kaluar vetëm 29 prej tyre ose 22.83%. Ndërkohë, që në afatin e dytë (10 tetor) në provimin e matyrës, nga të dy shkollat janë testuar 112 maturant, duke përfshirë edhe ata nga vitet e më hershme, ndërsa kanë kaluar 68 prej tyre apo 60.71 %, dhe atë në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 45 maturant, rezultat pozitiv kanë arrit 33 prej tyre ose 73.33 % e në ShMP nga gjithsej 67 maturant sa iu nënshtruan testimit, atë e kanë kaluar 35 prej tyre ose 52.23%.

Trajnimi i mësimdhënësve sipas fushave kurrikulare

Gjatë korrikut 2021, edhe pse në kushte pandemie, duke respektuar maksimalisht masat anti COVID, kanë vazhduar trajnimet e mësimdhënësve sipas fushave kurrikulare. Në këtë periudhë janë trajnuar gjithsej 22 mësimdhënës të fushave kurrikulare për klasat përgatitore, mësimin klasor dhe Gjuhë e Komunikim.

Trajnimet e kryera, gjithsesi janë në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë dhe zbatimit të Kurrikulës së re.

Funksionimi i organeve të shkollës

Ngritja e nivelit të përgjegjësisë, ndarja e punëve dhe përgjegjësi në përputhje me rolin dhe kompetencat e tyre.

Koordinatorët e përzgjedhur janë angazhuar në sigurimin e cilësisë përmes procesit të planifikimit gjithëpërfshirës ku janë pasqyruar nevojat dhe prioritetet e shkollave dhe në përgjithësi zhvillimin e arsimit në përputhje me pandeminë, ndërsa një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe monitorimin e procesit mësimorë, gjatë kësaj periudhe kanë pasur TASK Forca në nivel shkolle e DKA e po ashtu roli i tyre ka qenë edhe në krijimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në kohë pandemie COVID 19, edhe atë në distancë. Ekipet për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit si mekanizëm parandalues është angazhuar për mundësi të barabarta për të gjithë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

Investimet në infrastrukturën shkollore

DAK ka krijuar kushte të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Segment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i objekteve shkollore, zgjerimi i hapësirave dhe furnizimi me inventarë, kabinete shkollore e mjete të nevojshme për funksionimin e institucioneve shkollore. Janë përruruar objektet shkollore në Kaçanik të Vjetër dhe paralelen e ndarë në Kovaçec. Objektet e përruruar kanë hapësirë të mjaftueshme, ndërsa janë të ndërtuara me standarde bashkëkohore dhe moderne. Objekti shkollor në Kaçanik të Vjetër është financuar me mjete të MASH, e po ashtu ministria e ka bërë edhe furnizimin me inventar, ndërkaq objekti në Kovaçec është ndërtuar dhe financuar nga buxheti i komunës e po ashtu nga buxheti i komunës është bërë edhe furnizimi me inventarë shkollor. Dy objektet e përruara gjatë shtatorit dhe 3 të tjerat të përruara disa muaj më parë (në Gllloboçicë, financuar nga MASH, në Ivajë, financuar nga mjetet buxhetore të Komunës së Kaçanikut dhe objekti i QEAP "Agimi" i financuar me fonde të BE-së përmes MASH) kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve dhe zgjerimin e hapësirave shkollore. Ndërtimi i objekteve moderne sipas standardeve është edhe një faktor që luan rol të rëndësishëm në motivimin e nxënësve për punë rezultate më të mira dhe ngritjen e cilësisë.

Nga Buxheti Komunal janë investuar edhe në renovimin e objekteve tjera në vlerë prej 112 mijë euro.


Renovime janë bërë në: Gjimnazin "Skënderbeu" në Kaçanik, ku projekti ka përmbytur lyerjen / ngjyrosjen e brendshme të objektit dhe ndërrimi i dyerve të klasave e punë tjera teknike, ndërkaq në objektin e SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë është bërë rregullimi i ambientit të jashtëm, përkatësisht shtruarja e platos dhe shkallëve me kubëza betoni. Në infrastrukturën shkollore është investuar edhe në ShFMU "Jusuf Gërvalla" paralelja në Nikaj ku është rregulluar rrethoja e shkollës si dhe hapësira e jashtme dhe ri rregullimi i një klase e lyerja/ ngjyrosja e sajë, ndërsa në shkollën amë në Biçec janë ndërruar disa radiatorë për ngrohje me avull. Në SHFMU "7 Shtatori" në Begracë është bërë lyerja/ ngjyrosja e brendshme e objektit dhe ndërrimi i disa dyerve të klasave, ndërsa në ShFMU "Idriz Seferi" në Bob është rregulluar rrethoja dhe një pjesë e oborrit të shkollës, e në paralelen e ndarë në Gajre është ndërtuar tereni sportiv dhe në paralelen tjetër fizike në Kovaçec, është punuar rrethoja e shkollës dhe oborri, ndërkaq ka mbet të ndërtohet tereni sportiv.

Në ShFMU "Emin Duraku", në Kaçanik në të dy objektet është bërë lyerja/ ngjyrosja e brendshme, pastaj janë kryer punë hidrosanitarike dhe janë ndërruar disa dyer të klasave, ndërsa në ShMP " Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" është bërë lyerja/ ngjyrosja dhe rregullimi i dyshemesë sikurse edhe në ShFMU "Gafurr Luma" në Gllaboçicë ku janë kryer disa punë në hapësirën e jashtme të objektit shkolle.

Shënimi i datave të rëndësishme për rininë dhe organizimi i aktiviteteve kulturore

Përhapja e pandemisë COVID 19 ka kufizuar aktivitet pasi ruajtja e shëndetit ishte prioritet, ndërkohë disa nga aktivitetet, megjithatë janë shënuar. Të rinjtë kanë shënuar Ditën Ndërkombëtare të Tokës – pastrimi dhe mbjellja e fidanëve në hapësirat e qytetit. Është shënuar edhe Dita Ndërkombëtare e Librit ku përmes këtij aktiviteti janë përcjell mesazhe për rëndësinë e leximit dhe janë nxit të rinjtë që sa më shumë të lexojnë. Të rinjtë në bashkëpunim me Organizatën

PEN, kanë zhvilluar një fushatë me porosinë për masat mbrojtëse anti COVID 19. DAK dhe MKRS, edhe gjatë vitit 2020 e kanë mbështet financiarisht organizimin dhe mbajtjen e Festivalit të ShAKA "Kaçaniku 2020" të XXXII me radhë i cili është mbajtur virtualisht në përputhje me kushtet e pandemisë COVID 19.



DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT

Sektori i Buxhetit

Hapi i parë në fillim të çdo viti fiskal është përgatitja e rrjedhës së parasë (Plan Cash-i) për të gjitha programet buxhetore - drejtoritë dhe njësitë tjera organizative. Përmes këtij procesi bëhet përcaktimi i dinamikës mujore për zotimin dhe shpenzimin e mjeteve të planifikuara, sipas Buxhetit Komunal të aprovuar për vitin 2020.

Përkundër dorëzimit të Planit të Rrjedhës së parasë me kohë për zotim dhe shpenzim të mjeteve buxhetore, komuna është ballafaquar me probleme dhe vështirësi të shumta sa i përket aspektit financiarë, pra janë paraqitur vështirësi dhe pengesa në alokim të buxhetit me rastin e shfaqjes së Pandemisë, mirëpo duke parë këto vështirësi, kemi ndërmarrë disa vendime të njëpasnjëshme në vazhdimësi gjatë vitit pandemik rreth ri-harmonizimeve të mjeteve buxhetore me qëllim të tejkalimit të kësaj situate.


Me rastin e përfundimit të çdo viti fiskal, konform dispozitave ligjore bëhet bartja e bilanceve të pashpenzuara nga vitet paraprake, kështu edhe gjatë vitit 2020 nga DEFZH, në emër të Kryetarit të Komunës, është hartuar dhe propozuar para Kuvendit Komunal bartja e të hyrave vetjake të pashpenzuara nga viti 2019 në vitin 2020. Ky propozim Vendim i miratuar ka përfshirë ndarjen totale për bartje në shumë prej 263,423.10 euro të specifikuara dhe destinuara sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

Hartimi i propozim Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19. Përmes këtij vendimi të aprovuar nga Kuvendi Komunal janë ndarë mjetet në shumë prej 100,000.00 euro për menaxhimin e situatës pandemike. Kjo ka qenë shuma e ndarë nga buxheti ynë vetanak, ndërsa kemi menaxhuar edhe me fondet e alokuara nga niveli qendror për komunën tonë në kuadër të Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike, për këtë qëllim për komunë tonë jemi kujdesur që të pranojmë

alokimin në shumë prej 298,844.00 euro nga MAPL në kodin 00098 "Programi i rimëkëmbjes ekonomike". Përpos kësaj ndihme qeveritare, komuna ka pranuar buxhet shtesë edhe nga Ministria e Arsimit në shumë prej 55,744.33 euro.

DEFZH me kohë gjatë vitit 2020 është kujdesur për përgatitjen e raporteve periodike të realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve: (TM1,TM2,TM3,TM4 / 2020), si dhe për vitin e përfunduar me 31.12.2020 si dhe Raportimi në Kuvendit Komunal dhe dorëzimi në MF.

Më e rëndësishmja në aspektin e raportimit financiar është përpilimi i Pasqyrave financiare të Komunës për përfundimin e vitit fiskal 2020. Në vijim paraqesim vetëm tabelën përmbledhëse të realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve:



Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Komunën e Kaçanikut
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020

		2020	2019	2018	
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	
		BKK	BKK	BKK	
	Shënim	'000	'000	'000	
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET					
		8,499.49	7,346.66	7,157.20	
	Granti qeveritar	448.72	720.37	543.67	
	Të hyrat vetanake		-	-	
	Të hyrat e dedikuara		-	-	
	Të hyrat nga AKP		-	-	
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	10.86	6.01	91.14	
	Klauzola e investimeve		-	-	
	Fondi zhvillimor në mirëbesim		-	-	
	Pranimet tjera (Huamarrja)	66.83	38.48	19.29	
Gjithsej		9,025.89	8,111.52	7,811.30	
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT					
	Operacionet				
	Paga dhe rroga	2	5,232.50	4,959.25	4,925.42
	Mallra dhe shërbime	3	1,725.42	824.64	823.68
	Shpenzime komunale	4	183.23	140.48	110.32
			7,141.15	5,924.37	5,859.42
	Transferet				
	Transfere dhe subvencione	5	230.24	215.42	306.77
	Shpenzime kapitale				
	Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	1,654.08	1,971.73	1,645.10
	Pagesa tjera	7			
Gjithsej			9,025.47	8,111.52	7,811.29

Gjatë vitit 2020 janë organizuar dëgjimet publike lidhur me hartimin e buxhetit për vitet 2021-2023 dhe dhënien e informative për shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2020 në kuadër të ngritjes së transparencës buxhetore dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Prezantimi i Qarkores 01/2020 sipas kufijve fillestarë buxhetor dhe hartimi i buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023 konform qarkores finale 02/2020 nga MEF.

Harmonizimi i kërkesave të drejtorive dhe futja e prioritetëve komunale sipas kufijve buxhetor.

Përgatitjet për rishikimin buxhetor, harmonizimet si dhe propozimi për rishikimin buxhetor 2020.

Spektori i Pagesave

Përgatitjet fillestare për fillimin e sistemit të pagesave (Free Balanc) për vitin fiskal 2020.

Arkëtimi i të gjitha llojeve të pagesave në të gatshme, të realizuara përmes trezorit të Arkës së Administratës Komonale dhe nga programet e tjera buxhetore në nivel të Organizatës Buxhetore të Komunës. Mbajtja e evidencave të sakta ditore, mujore dhe vjetore të arkëtimeve sipas llojit të të hyrave, sistemimi dhe depozitimi i të gjitha arkëtimeve në bankat komerciale (përgatitja e raporteve ditore, mujore dhe vjetore), si dhe barazimi reciprok me drejtoritë të cilat krijojnë të hyra.

Aplikimi i Petty Cashit. Realizimi i pagesave të imëta (nën vlerën 100 euro), sipas rregullave KMF.

Raporti përmbledhës i aprovimit të pagesave gjatë vitit:

- Mallra dhe Shërbime janë shpenzuar 1420 pagesa që në total 1,660,195.44 €;
- Komunali janë shpenzuar 947 pagesa që në total 183,232.58 €;
- Subvencione janë shpenzuar 153 pagesa 230.235.16 € dhe
- Investime kapitale janë shpenzuar 178 pagesa 1,635,535.84€.

Spektori i Tatimit në Pronë

Zyra e Tatimit në pronë në bazë të Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2020 – 01 Nr.05-430/03-36755/19, ka bërë përgatitjen dhe hartimin e planit për shtypjen dhe shpërndarjen e faturave të tatimit për vitin 2020.

Risi për vitin tatimor 2020 ka qenë edhe ngarkimi dhe faturimi i parcelave (40%) që ka të bëjë me Ligjin Nr.06/L-005-Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë.

Pos punëve të përditshme, zyra e tatimit në pronë ka bërë shtypjen dhe zarfimin e faturave tatimore për vitin 2020 dhe atë për secilën Zonë Kadastrale, për objekte dhe për parcela, pra për 29 zona kadastrale. Në vazhdimësi me shtypjen e faturave kemi filluar edhe shpërndarjen e tyre nëpër adresa të pronës e që të njejtat janë shpërndarë. Vlen të theksohet se për shpërndarjen e tyre janë angazhuar edhe punëtor shtesë dhe se faturat janë shpërndarë me kohë.

Menjëherë pas fillimit të shpërndarjes së faturave tatimore ka filluar edhe procedura e ankesave dhe atë nëse:

- Fatura e tatimit në pronë është e pasaktë;
- Ekzistojnë gabime në regjistrat e tatimit në pronë mbi të cilat është bazuar fatura e tatimit në pronë; apo
- Fatura e tatimit në pronë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-005 mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Gjatë afatit të ankesave për vitin 2020, zyra e tatimit në pronë ka pranuar 59 ankesa për objekte dhe atë sipas kategorive të pronës të ndryshme. Por gjatë këtij viti ka qenë risi edhe ankesat për parcela që janë bërë pran ZTP dhe numri i tyre është 67. Të gjitha ankesat e arritura janë vizituar në terren nga anketuesit e ZTP dhe janë shqyrtuar brenda afatit ligjor.

Nga MF-DTP është bërë vlerësimi i pronave komerciale dhe industriale me çka rumbullakoset gjithçka rreth vlerësimit të pronave.

Gjatë vitit 2020 deri më datën 30.11.2020, janë paguar gjithsej 3649 fatura në vlerë prej 229.256,73 €, shumë e cila është më pakë në krahasim me vitin paraprak për 33.377,73 €.

Kjo rënie e treguar në inkasim ka ardhur si rezultat i shfaqjes së Pandemisë COVID 19. Ndikimit të saj negativ kishte tek të ardhurat e bizneseve dhe ekonomive familjare, gjë që ka sjellë vështirësi në përgjigjeje ndaj pagesave të tatimit në pronë, po ashtu edhe mungesa e mërgatës gjatë këtij viti ka rezultuar me rënie të të hyrave vetanake, përkatësisht rënie e të hyrave të tatimit në pronë.

Në fillim të vitit 2020, është hartuar edhe plani i rianketimit, por nuk janë rianketuar pronat pasi që ka qenë vit pandemik.

Për shkak të prezencës së Pandemisë COVID 19, me qëllim të lehtësimit të gjendjes së tatimpaguesve, MEF-DTP ka nxjerrë Vendim me të cilin shtyhen:

- Afati për lëshimin e faturave të tatimit në pronë shtyhet deri më 31 Mars 2020;
- Afati i pagimit të këstit të parë të detyrimeve të tatimit në pronë shtyhet deri me 30 Qershor 2020;

- Afati i paraqitjes së ankesave ndaj faturave të tatimit në pronë dhe certifikatave të vlerave të vlerësuar shtyhet deri me 31 Maj 2020.

Po ashtu MEF-DTP ka vendosur që gjrobat dhe interesi për vitin 2020 të mos llogariten deri në fund të vitit.

Udhëzimi administrativ Nr.7/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në prone. Janë lëshuar një numër i konsiderueshëm i vërtetimeve që kanë të bëjnë me shërbimet e Kadastrave komunale, kërkesa për caktimin e kushteve urbanistike, kërkesave për leje ndërtimi si dhe kërkesa tjera që bëhen në këtë drejtori. Për taksën për regjistrimin e automjeteve motorike kemi lëshuar gjithsej 4563 vërtetime, si dhe për jo tatimpagues dhe për asistencë sociale janë lëshuar 771 vërtetime.

Zyra e tatimit në pronë ka identifikuar edhe tatimpaguesit të cilët nuk janë përgjigjur pagesës së tatimit në prone edhe pasi u është dërguar edhe vërejtja e fundit për mos pagesën e tatimit në pronë dhe janë në vazhdim për procedura përmbarimore.

Spektori i Zhvillimit Ekonomik

Zyra e lokale e regjistrimit të bizneseve

Gjatë vitit 2020 në Komunën e Kaçanikut janë hapur gjithsej 105 biznese të reja. Prej tyre: 62 biznese individuale dhe 43 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Biznese individuale janë hapur gjithsej 62, nga të cilat 12 biznese janë me pronare femra dhe 50 biznese me pronar meshkuj.

Biznese me shoqëri me përgjegjësi të kufizuar gjatë vitit 2020 janë hapur 43 sosh, nga të cilat 2 biznese kanë qenë me pronare femra dhe 41 biznese tjera me pronar meshkuj.

Nga bizneset e hapur gjatë vitit 2020, shumica ose pjesa më e madhe e tyre përfshijnë aktivitetet si vijon:

1. Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore;
2. Instalime tjera ndërtimore;
3. Punime suvatimi;
4. Aktivitet shërbyes të pijeve;
5. Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar ku mbizotëron ushqimi, pije jo alkoolike dhe duhani.

Gjatë vitit 2020, 85 biznese kanë aplikuar për ndryshime në bizneset e tyre aktuale. Kërkesat kanë qenë të ndryshme si më poshtë:

1. Kërkesë për ndryshim emri;
2. Kërkesë për ndryshim pronari;
3. Kërkesë për tipit biznesit;
4. Kërkesë për ndryshim adrese;
5. Kërkesë për ndryshim aktiviteteve etj.

Vlen të theksohet se me udhëzimin administrativ (MTI) Nr.03/2020 të datës 07.07.2020 tek bizneset individuale nuk lejohet ndërrimi pronarit.

Gjithashtu tek kërkesat për ndryshim adrese, shumica kërkesave kanë qenë nga Bizneset nga Komuna Hanit i Elezit, të cilat janë regjistruar më herët dhe figurojnë me adresë biznesi në Komunën e Kaçanikut.

Gjatë vitit 2020, janë shuar 8 biznese, të gjitha kanë qenë Biznese Individuale. 2 nga 8 bizneset e mbyllura kanë me pronarë Femra ndërsa 6 biznese kanë qenë me pronar Meshkuj.

Bizneset kanë bërë 271 kërkesa për Çertifikata të reja, arsyeje e pajisjes së këtyre bizneseve me Çertifikata të reja është aplikimi Numrit Unik Identifikues (NUI). Sipas kësaj, të gjitha bizneset të regjistruar para vitit 2018 automatikisht iu ka ndryshuar numri biznesit si rrjedhojë numri biznesit dhe numri fiskal i biznesit bashkohen në një numër të vetëm 9-shifror pra NUI (Numri Unik Identifikues).

10 biznese kanë kërkuar Çertifikata Dublikatë, me arsyen e humbjes të Çertifikatave të biznesit.

109 Biznese kanë kërkuar "Informatat e Biznesit", shumica kërkesave kanë qenë për përditësimin e llogarive në Bankat Komerciale, kërkesë e bankave që bizneset çdo 6 muaj t'i përditësoj (rifreskojnë) të dhënat e biznesit në llogaritë e tyre bankare.

Gjithashtu ne si zyre kemi pasur edhe kërkesa tjera nga bizneset të cilat ishin kërkesa për vërtetim që nuk kanë obligime ndaj Komunës së Kaçanikut, Vërtetime të tilla iu shërbenin për aplikim nëpër tenderë e që gjatë vitit 2020 kishte gjithsej 14 kërkesa të tilla.

Nga persona fizik kishte 10 kërkesa për vërtetim që nuk ka biznes të hapur, këto vërtetime zakonisht iu nevojiteshin për aplikim për ndihmë sociale në komuna tjera.

Në vitin 2020, Kuvendi Komunal miratoi rregulloren e Komunës për Taksa dhe Ngarkesa, nga e cila bizneset e Komunës së Kaçanikut liroheshin nga ngarkesa me taksë të ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve.

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Gjatë këtij viti DUKMM-ja përkundër sfidave të mëdha ka arritur t'i kryej projektet e parapara. Arritja më e madhe për këtë drejtori është definimi i 20% të objektit të banimit me marrëveshje me BK-Center. Këtu në bazë të kësaj marrëveshje komunës i takojnë 2187.4m² ose shndërruar në njësi banesore 36 banesa të cilat edhe janë bartur në emër të Kuvendit Komunal.

Kontrata që është dyvjeçare (2019-2020), hartimi i projekteve janë :

- Kanalizimi në f. Begracë;
- Projekt kryesor i ndriçimit publik dhe shiritit të këmbësorëve, segmenti: Shkolla "Feriz Guri -Vëllezërit Çaka" në Bob deri te ura e banovinës në f. Doganaj-Kaçanik;
- Projekti kryesor të objektit të zjarrfikëseve në Kaçanik;
- Hartimi i projektit kryesor të shtrirjes së kolektorit kryesor të rrjetit të Kanalizimit Fekal për segmentin: Gërllicë-dalje e Kaçanikut (Guri i Shpumë);
- Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve të qytetit;
- Projekti zbatues për ndërtimin e urës mbi lumin Nerodime në Kaçanik të Vjetër;
- Projekti kryesor për ndërtimin e fushës së futbollit me bari natyral;
- Punët në ekzekutimin e projekteve të DUKMM-së që janë përfunduar;
- Rregullimi dhe shtrimi i bulevardit "Ismail Raka";
- Rregullimi zgjerimi i rrugës "Aydurrahim Shehu";
- Rregullimi i disa përrojëve në baze të prioriteteve;
- Fasadimi i objekteve në qytet;
- Rregullimi i rrugëve lokale;

-Jemi angazhuar në hartimin e PZHK-së e cila është vonuar për shkak të pandemisë, por shumë shpejt do të dalim në debat për ti dhënë dorën e fundit;

Kemi pasur si drejtori 137 kërkesa për legalizim janë legalizuar në këtë vit 69 dhe janë proceduar për kadastrë 38, në proces janë 68 kërkesa;

Janë larguar 20 deponi me Projektin për largimin e deponive ilegale;

Janë lëshuar 12 leje ndërtimore dhe 3 janë në proces.

Sektori i kadastrit

Gjatë vitit paraprak pranë sektorit të kadastrit kemi pranuar dhe janë regjistruar 5637 lëndë, ku nga ky numër janë zgjedhur të gjitha kërkesat e pranuar nga ana e palëve fizike apo juridike.

Ky sektor ka vazhduar me përpikmëri të bëjë implementimin e ligjit mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së paluajtshme Nr. 2002/5 dhe plotësimit të tij Nr.2003/13, si dhe ligjit mbi hipotekat Nr.2004/4.

Nga lëndët sa u përket Çertifikatave, Fletët Poseduese, Kopjet e Planit, Kordinatave gjeodezike etj. dhe lëndët e tjera nga RDPP, të gjithat janë të kryera dhe të dorëzuara brenda afatit ligjor që donë të thotë se nuk ka pasur ngecje në punë dhe palët kanë qenë të shërbyer në afatin optimal. Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasinë e kërkesave për secilën kategori veç e veç dhe atë: Dokumentet e lëshuara 5637 lëndë:

• Fleta poseduese	2409 lëndë
• Kopje të planit	949 lëndë
• Çertifikata të gjendjes së pasurisë	783 lëndë
• Koordinata gjeodezike	649 lëndë
• Identifikime	00 lëndë
• Të ndryshme (AKP, Gjykatat, K.K Kaçanik etj.)	47 lëndë
• Regjistri i RDPP-së	795 lëndë

= Regjistri i RDPP-së 795 lëndë:

Bartja e posedimit - Ndarje fizike e pasurisë familjare	12
Bartja e posedimit - Blerje	157
Bartja e posedimit - Dhurim	175
Bartja e posedimit - Këmbim	16
Bartja e posedimit - Trashëgimi	61
Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit	21
Bartja e pronësisë - Ndarje fizike	2
Bartja e pronësisë - Blerja	12
Bartja e pronësisë - Dhurata	5
Bartja e pronësisë Aktgjykim dhe fitime tjera të pronësisë	1
Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme	5
Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme pa njësi	1
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	23
Fshirja e vërejtjes me vendim të gjykates	2
Fshirja e vërejtjes pas skadimit të afatit	1
Krijimi i Bashkëpronësisë	1
Modifikimi i attributeve të pjesës së ndërtesës	2
Modifikimi i hipotekës	3
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	16
Modifikimi i të drejtave	9
Ndarja	189
Ndarja e pjesës së ndërtesës	1
Regjistrimi i hipotekës	17
Regjistrimi i ndërtesës (përfshirë edhe Legalizimi Objekteve)	28
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	1
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	16
Regjistrimi i qiramarrjes/nënqiramarrjes	8
Regjistrimi i servitutit I	1
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	4
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykates	5

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operatit Kadastral me atë tekstual.

Gjithashtu gjatë viti paraprak kemi implementuar edhe Udhëzimin Administrativ nr.03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Ku përmes këtij udhëzimi bashkëshortët të cilët kanë shpreh vullnet që të regjistrojnë pronën e paluajtshme si pasuri të përbashkët kanë qenë të liruar nga pagesa e taksave pranë zyreve kadastrale komunale. Ky udhëzim ka filluar të implementohet nga Marsi i vitit 2016 deri më Mars të vitit 2017, dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës ky afat është zgjatuar edhe për një vit nga Prilli i vitit 2017 deri në vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eliminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.


Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siç janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, etj.

Gjithashtu asistenca dhe bashkëpunimi profesional nuk ka munguar dhe ndaj institucioneve shtetërore siç janë: Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ministria e Infrastrukturës etj., ndërsa me informacione të ndryshme sipas kërkesës është përkrahur edhe Gjykata Komunale.

Sektorin për çështje pronësore-juridike gjatë periudhës raportuese është marrë me punët dhe detyrat që i takojnë këtij Sektori dhe atë nga lëmia e uzurpimit arbitrar të Pronës Komunale dhe asaj publike, Shpronësimit, Mbajtjes së evidencës së Pronës Komunale si dhe mënyrat e rregullimit të marrëdhënieve pronësore-juridike, informata dhe raporte për organe të ndryshme ku gjatë viti 2020 kemi pasur rreth 13 lëndë

Gjithashtu në fund të vitit 2020 është pranuar edhe Elaborati i Autostradës "Prishtinë – Shkup" i cili do të procesohet dhe ekzekutohet gjatë viti 2021.

Në kuadër të legalizimeve kemi vazhduar me procesin e legalizimit të objekteve-ndërtesave dhe ekzekutimin e tyre në planet digjitale kadastrale dhe pjesën tekstuale të SIKTK-së sipas ligjit dhe akteve të tjera ligjore në fuqi mbi Legalizimet.



DREJTORIA E EMERGJENCAVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

Raporti përmbledhës i punës njëvjeçare në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka për qëllim të raportimin për kryetarin e komunës, komitetit për Shërbime Publike si dhe informimin e opinionit publik për punën e DSHPE-së për periudhën Janar-Dhjetor 2020.

Është raport përmbledhës dhe njëherit paraqet punët e përgjithshme të kësaj drejtorie të cilat në një formë apo tjetër kanë ndikuar drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit.

Të gjitha aktivitetet e poshtëshënuara janë realizuar në bashkëpunim të plotë me kryetarin e komunës dhe drejtoritë tjera të ekzekutivit komunal.

NR.	EMËRTIMI	GJATËSIA/M
1	Ndërtimi i rrugëve në fshatin Begracë	
	a. Rruga "Pavarësia"-degëzimet I.II.II	462m
	b. Rruga "Shefki Gashi"	122m
	c. Rruga "Salla Luzha"	420m
2.	Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Gajre	950m
3	Ndërtim dhe asfaltim i rrugëve në fshatin Gllloboqicë	
	a.Rr. "Tre Vëllezerit"	195m
	b.rr."Hisen Qaushi"	278m
	c.rr. "Dëshmorët e Gllloboqicës"	93m
	d.rr."Hasa"	180m
	e. rr. Mustafë Luma"	51m
4	Asfaltimi i rrugëve të lagjes Tushaj-Soponicë	645m
5	Ndërtim i rrugës në lagjet Dalloshi, Murseli dhe Cena-Doganaj-rregullimi i trasesë	1263.5m
6	Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Bob	140m

7	Zgjerimi i rrugës "Shaban Elezi" - Sllatinë	410m
	Total	5209.5m

Implementimi i projekteve nga Granti i Performancës:

Në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit me MAPL-në, me qëllim të implementimit të projekteve nga Grand i Performancës kemi përfituar 169,508.00€, kemi implementuar (2) dy projekte në rregullimin e infrastrukturës rrugore. Komuna ka bashkëfinancuar në projektin "Rehabilitimi i bulevardit Ismajl Raka dhe Qamil Ilazi"" dhe projektin "Zgjerimi i rrugës "Avdurrahim Shehu".

NR.	EMËRTIMI	GJATËSIA/M
1	Rehabilitimi i Bulevardit "Ismail Raka" dhe "Qamil Ilazi" - Kaçanik	990m
2	Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës "Avdurrahim Shehu"-Kaçanik	1440m

Ujësjiellësi

Rregullimi i sistemit aktual të ujësjiellësit dhe ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjiellësit

Është finalizuar projekti "Sanimi , rekonstruimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore në sitemin ekzistues të ujësjiellësit për fshatrat Dubrave, Rekë, Nikaj, Soponicë, Doganaj, Elezaj, Koxhaj, Sllatinë dhe Kaçanik i Vjetër, projekt i financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit(ish MMPH-ja). Me marrëveshje te menaxhimit dhe mirëmbajtjes është dorëzuar KRU "Bifurkacioni" sistemi i ujësjiellësit për fshatrat Nikaj, Dubravë, Doganaj, Elezaj, Rekë dhe Stagovë.

Në kuadër të projektit "Ndërtimi i rrjeteve të ujësjiellësit" është vendosur gypi nga lagjja Beljan deri te restoran Shqiponja -Provoli në gjatësi 2300m si dhe janë siguruar gyp ujësjiellësi Ø315 =800m dhe Ø110 =2000m për nevojat e rrjeteve aktuale të ujësjiellësit.

Furnizimi dhe vendosja e gypit të ujës-jellës në rrugën "Avdurrahim Shehu" në gjatësi 1600m ($\varnothing 160 = 800\text{m}$ dhe $\varnothing 110 = 800\text{m}$), si dhe janë bërë kyçjet individuale të familjeve.

Kanalizimet

Në kuadër të kodit buxhetor "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike" janë realizuar këto projekte në ndërtim të kanalizimeve në gjatësi totale $L=5565\text{m}$ (Kanalizim Fekal $L=4805\text{m}$ dhe Kanalizim atmosferik $L=760\text{m}$), Vlera e projektit **88,037.86€** (maj 2020-maj 2021), Vlera e punimeve të kryera në vitin 2020 **79,996.10€**.

Nr.	Emërtimi i projektit	Gjatësia	Profili Gypit	i
1	Kanalizimi në lagjen Memaj-Vatë-fsh.Dubravë	2550m	$\varnothing 315/\varnothing 250$	
2	Ndërtimi kanalizimit fekal në fshatin Stagovë -Faza I	1680m	$\varnothing 315$	
3	Ndërtimi kanalizimit atmosferik në fshatin Stagovë-lagjja Bajrami -Faza I	230 m	$\varnothing 400$	
4	Ndërtimi i kanalizimit në fsh.Kaçanik i vjetër –lagjja e Trimave	195m	$\varnothing 250$	
5	Kanalizimi në Llanishtë	50m	$\varnothing 200$	
6	Kanalizimi në Lagje të re Rr.Nevzat Qallaku	80m	$\varnothing 200$	
7	Kanalizimi të shkollës Provoli	50m	$\varnothing 200$	
8	Kanalizimi atmosferik në Rr.Avdurrahim Shehu	45m	$\varnothing 1000$	
9	Vendosja e gypave në kanal të ujitjes Provoli	12m	$\varnothing 800$	
10	Kanalizimi atmosferik në Lagjja Muçaj-fsh Kovaçec	41m	$\varnothing 1000$	
11	Sigurimi dhe montimi i kapakeve metalik të pusëve - Rr.25maji Dubravë	3 copë		
12	Sigurimi dhe montimi i kapakeve metalik të pusëve - Rr.Remzi Hoxha-Kaçanik	2 copë		
13	Sigurimi dhe montimi i kapakeve metalik të pusëve - Rr.Rexhep Luzha-Begracë	1 copë		
14	Kanalizimi fekal në fshatin Ivajë	120m	$\varnothing 200$	
15	Kanalizimi atmosferik në lagjen Krraba dhe te ura fsh.Stagovë	74m	$\varnothing 400/\varnothing 315$	
16	Kanalizim i atmosferik Fsh.Duraj të xhamia	200m	$\varnothing 315$	

17	Kanalizimi atmosferik në Gllloboçicë	36m	ø800
18	Kanalizimi atmosferik-Lëshesat në fsh.Gabrricë	22m	ø800
19	Pastrimi i përrockës në fsh. Kovaqec	355m	
20	Pastrimi i përrockës në fsh. Stagovë, lagjja Hysaj	100m	
21	Kanalizimi fekal te shkolla në fsh. Gajre	80m	ø200
22	Ndërtimi kanalizimit atmosferik në Lagjen Topalli	100m	ø400
Total		5565m	

Ujërat sipërfaqësore

Gjatë këtij viti kemi investuar në ndërtimin e disa rrjeteve të ujërave atmosferike. Kemi ndërtuar rrjetin e kanalizimit të ujërave atmosferike dhe ndërtim të shtretërve të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese:

EMËRTIMI	GJATËSIA
NDËRTIMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK TË RRUGËS KRYESORE NË FSHATIN BIÇEC	580m
NDËRTIMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK NË BULEVARDIN "ISMAJL RAKA"	980m
PASTRIM I SHTRITËRVE TË PËRROCKAVE (TE VIVA DHE NE FSHATIN KOVAQEC)	400m
PASTRIMI I SHTRITIT TË LUMIT NERODIME	680m
PASTRIMI I PËRROCKËS NË FSHATIN STAGOVË- LAGJJA HYSAJ	100m

Menaxhimi i Mbeturinave

Edhe gjatë këtij viti jemi fokusuar në implementimin dhe realizimin e objektivave të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021.

Kemi vazhduar në implementimin e projektit "Furnizimi me shporta për mbeturina 120l". Ka vazhduar shpërndarja e shportave klientëve të rinj.

Kemi lidhur marrëveshje me operatorin privat NTSH "Krasniqi"-Kaçanik i Vjetër për grumbullim të mbeturinave në Zonën e III-të.

Jemi përfitues dy here radhazi në garën Grandi i Performancës-Mjedisi i Pastër.

Raundi i parë=60,463.00€,

Raundi i dytë=117,698.00€, duke u radhitur në vendin e katërt në nivel të komunave të Kosovës me performancë vjetore më të mirë.

Aktualisht mbulueshmëria e vendbanimeve të komunës me shërbime të menaxhimit të mbeturinave arrin 64%.

Komunikacioni Rrugor

Shenjëzimi Horizontal dhe Vertikal

Gjatë vitit 2020 përmes kompanisë për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal kemi realizuar projekte të kësaj fushe në shenjëzim horizontal dhe vertikal në rrugët lokale:

Shenjëzim të vijës ndarëse të rrugës (të plotë dhe të nderprerë) dhe vendosje të shenjave vertikale të trafikut është realizuar në:

Rr."Ismajl Raka"-bulevardi Kaçanik;

Rr."Komandant Bardhi" K.Vjeter –Begracë;

Rr"Nazmi Osmani"-Elezaj;

Rr."Beteja e 25 Majit" segmenti Soponicë-Dubravë;

Rr."Mulliri i Nikës"-Soponicë;

Rr."Avdurrahim Shehu"-Kaçanik;

Ndërsa vendosje e shenjave vertikale të trafikut janë bërë në:

Rrugët "Vëllezrit Çaka", "Izahir Troni", "UÇK" -segmenti/Bob-Doganaj;

Rr. "Baki Dullovi"-Biqec;

Rr. "Feriz Guri"-Nikaj;

Rr. "Brigada 162 Agim Bajrami"-segmenti Gajre-Ivajë dhe

Rr. "Skenderbeu"-Kaçaniksinjalizimit aktual.

NR.	EMËRTIMI	SASIA
Sinjalizim vertikal		
1.	Shenja të rrezikut	50 copë
2.	Shenja të urdhëresave të prera	97
3.	Shenja të lajmërimit	22
4.	Pahi elastike	60m
5.	Shtylla antipark	7
Sinjalizim horizontal		
1.	Vijë e plotë	5878m
2.	Vijë e ndërprerë	7752m
3.	Vijë stop	120m ²
4.	Vijë shenjëzimi për parkingje	88m+
5.	Barriera (policë të shtrirë)	44m
6.	Vendkalime për këmbësor	18 vendkalime

Po ashtu janë punuar edhe vendkalimet për këmbësor (të ngritura) afër shkollave fillore dhe të mesme.

Hapësirat Publike Gjelbërimi dhe Parqet

Në kuadër të projektit "Rregullimi dhe ndërtimi i parqeve publike" është bërë rregullimi i hapësirës dhe parkingut te banesa P+8 dhe rregullimi i hapësirës për lodra të fëmijëve në parkun e qytetit.

Vlera e projektit ka qenë 24,999,99euro.

- Projekti "Krasitja e drunjëve dekorativ" në bulevardin e qytetit.

Vlera e projektit= 1,290€

Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave

Gjatë vitit 2020 është bërë pastrimi dhe kujdes i vazhdueshëm i varrezave të dëshmorëve, posaqërisht pra çdo date të shënuar për përkujtime apo festa shtetërore dhe komunale. Është mirëmbajtur hapësira e gjelbëruar, lulet dhe drunjët dekorativ.

Gjithashtu kemi përfituar një projekt nga OSBE-ja "Rregullimin e rrethojës së varrezave të vjetra të qytetit".

Vlera e projektit është: 16,000.00€

Trotuare dhe ura

Gjatë vitit 2020 në kuadër të investimeve kapitale janë ndërtuar edhe 6 projekte të trotuarëve për këmbësorë.

Nr.	Emërtimi i projektit	Gjatësia/m
1.	Ndërtimi i trotuarit në rr. Epopeja e UÇK-së –K. Vjetër	2,500m
2.	Ndërtimi i trotuarit Bob-Doganaj-faza II	1,700m
3.	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Doganaj	560m
4.	Ndërtimi i trotuarit në lagjen Topalli-Soponicë	900m
5.	Ndërtimi i trotuarit në rr."Batalioni i III-të -Gllloboqicë	110m
6.	Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Avdurrachim Shehu"-Kaçanik	1200m

TOTALI

6970m

Ndërtim i stazave për këmbësorë

Është bërë ndërtimi i stazës së re për këmbësor përgjat urës në fshatin Stagovë dhe rehabilitimi i stazës ekzistuese te përroi i Rakocit

Nr	Emërtimi i projektit	Gjatësia
	Rehabilitimi i stazës për këmbësor përgjatë përgjatë përrockës se Rakocit	40m
3	Rregullim i stazës për këmbësor përgjatë urës në Stagovë	22m
	Total	62m

Ndriçimi Publik

Projekti kapital "Rregullimi i ndriçimit publik", shumë 50,000.00€ është ekzekutuar në këto lokacione:

Nr	Emërtimi i projektit /Lokacioni i punishtes	Gjate sia(m)	Nr.Trup ave
1	Rruga "Nazmi Osmani" fsh. Elezaj	1457	38
2	Rruga "Kjani Bela" Kaçanik	280	9
3	Rruga "Selim Shehu" Kaçanik	750	21
4	Rruga "Burim Rexha" Kaçanik	260	7
5	Rruga "Emsale Frangu" Kaçanik	480	13
6	Rruga "Jehona Raka" Kaçanik	300	7
7	Rruga "TMK-së" fsh. Runjevë-faza 1	500	19
8	Rruga "Remzi Hoxha" Kaçanik	400	13
9	Rruga "Raif Krivanjeva" Kaçanik-faza 2	300	11

10	Ndriçimi i fushës sportive në oborret e shkollave "Qamil Ilazi" dhe "Nazmi Osmani"		8
11	Rruga "Hasan Prishtina-Mukadeze Lika" Kaçanik	710	21
12	Rruga "Reshat Shehu" Kaçanik	250	7
13	Rruga "Nexhmush Elezi" Kaçanik	250	5
14	Ndriçimi te lapidari i dëshmorëve në fsh. Kovaçec		3
15	Rruga "Blerim Raka" Kaçanik	375	9
16	Rruga "Shaqir Kuka" Kaçanik	150	3
17	Rruga "Faik Konica" Kaçanik	140	6
18	Rruga "Izahir Troni" Kovaçec	650	8
19	Ndriçimit publik në Rr."Ilirët", fsh.Dubravë	1100	34
20	Rruga "Malsia" -fsh.Rekë	1550	38
21	Rruga "Mynyr Thaçi"-Kovaçec	1060	33
22	Rruga "Sadik Guri"- fsh.Nikaj	1450	24
TOTAL			337

12,41
2m

Mirëmbajtje e rrjeteve ekzistuese

Po ashtu gjatë këtij viti është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik për periudhën (3) trevjeçare, ku jemi angazhuar në mirëmbajtjen e ndriçimit aktual dhe zgjerimit në disa pjesë të lagjeve urbane të qytetit,

Vlen të ceket se drejtoria e shërbimeve publike në rastet kur ekziston gatishmëria e komuniteteve për të rregulluar me vetëfinancim rrjete të caktuara të ndriçimit

publik në lagje apo rrugica të ndryshme, jep pëlqime për rregullimin e ndriçimit publik dhe merr përsipër shpenzimet mujore të energjisë elektrike.

Këtë vit janë realizuar projekte të ndriçimit publik të kësaj forme në:

Fshati Begracë- rr. "Rexhep Luzha", rr. "Mehmet Begraca" dhe rr. "Toska",

Fshati Begracë- rr. Pavarësia", rr. Rilindja" dhe rr. "Rexhep Gashi",

Fshati Sllatinë, rr. "Shaban Elezi",

Fshati Lekaj-rr. "Avni Shehu" dhe "Trimat e Lirisë".

Mirëmbajtja e rrugëve lokale

Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale 2019

Gjatë vitit 2020, DSHPE-ja është angazhuar në vazhdimësi në realizimin e kontratës për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve lokale gjatë sezonës verore dhe dimërore. Krahas mirëmbajtjes rutinë gjatë kësaj kohe si (largimi i dheut nga rrëshqitjet, mbushja e gropave me shtresë asfalti, pastrimi i kanaleve të ujërave atmosferike, ndërtim i mureve mbrojtëse, largimi i borës, hedhja e kripës industriale, etj.), janë bërë edhe rehabilitime të dukshme të rrugëve me shtresë zhavorri dhe shtresë të re asfalti.

Në vitin 2020 me projektin e mirëmbajtjes së rrugëve janë kryer këto punime:

- Pastrimi i borës dhe hedhja e kripës industriale në rrugët lokale;
- Pastrimi i rrugës në fsh. Gajre nga shembjet e dheut;
- Pastrimi i rrugës në fsh. Sllatinë nga shembjet e dheut;
- Shtrimi me kubëza të betonit tek prerjet e asfaltit në fsh. Kaçanik i Vjetër dhe tek "Silcapori";

- Shtrimi me zhavorr tek ura mbi lumin Neredime në fsh. Kaçanik të Vjetër;
- Pastrimi dhe larja e rrugëve të qytetit me autobot;
- Pastrimi i rrugës në lagjen Lamaj nga shembjet e dheut;
- Shtrimi me zhavorr i degëzimit të rrugës "Çlirimtarët" në fsh. Kaçanik të Vjetër, me gjatësi L=605 m;
- Shtrimi me zhavorr tek varrezat e lagjes "Neziraj";
- Shtrimi me zhavorr i degëzimit të rrugës "Shaban Elezi" në fsh. Sllatinë, me gjatësi L=260 m;
- Rehabilitimi i rrugës "Remzi Zharku" me gjatësi L=275 m;
- Rehabilitimi i rrugës "Beteja e 25 majit", me gjatësi L=505 m;
- Hapja e degëzimit të rrugës "Qemal Guri" në fsh. Nikaj me gjatësi L=630 m;
- Pastrimi nga mbeturinat dhe mbushja me zhavorr e rrugës "Feriz Guri" në fsh. Nikaj;
- Zhbllokimi i kanalizimit të lagjes "Troni" në fsh. Kovaçec;
- Pastrimi nga mbeturinat, nivelizimi dhe mbushja me zhavorr e parkingut në rrugën "Idriz Seferi"-Kaçanik;
- Shtrimi i gropave me zhavorr në rrugën "Idriz Seferi";
- Shtrimi me zhavorr tek varrezat e fsh. Kaçanik i Vjetër;
- Rehabilitimi i rrugës "Dëshmorët e Kombit" në lagjen e Dushkajës;
- Rehabilitimi i rrugës "Raif Krivanjeva" me kubëza betoni në Kaçanik;
- Rehabilitimi i gropave me asfalt në rrugët lokale ;

- Nivelizimi dhe shtrimi i rrugës me zhavor në fsh. Ivajë (Ivajë e Vjetër) me gjatësi L=1383 m;
- Zgjerimi dhe nivelizimi i tri (3) rrugëve në fsh. Sllatinë me gjatësi prej 3 km;
- Rehabilitimi i rrugës "Ejup Dushkaja";
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës "Shaban Demnika";
- Rehabilitimi i kanalit të ujësjellësit të fsh. Doganaj në Luboten;
- Rehabilitimi i rrugës "Jenuz Kamishi" me zhavorr;
- Nivelizimi i oborrit të shkollës fillore në fsh. Gajre;
- Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën "Sulejman Kuka" në Kaçanik me gjatësi L=7.2 m;
- Shtrimi me kubëza betoni në rrugën "Triumf Riza"-Stagovë;
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës në lagjen "Provoli" me gjatësi L=757 m;
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës "Fitorja" në fsh. Elezaj me gjatësi L=275 m;
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor degëzimit të rrugës "Nazmi Osmani" në fsh. Elezaj me gjatësi L=53 m;
- Rehabilitimi i gropave me zhavor në rrugët "Hajdin Bela" dhe "Ramadan Bela" në Kashan;
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavorr i rrugës në fsh. Begracë me gjatësi L=135 m;
- Rehabilitimi i rrugës(me asfalt) "Besnik Begunca" në Lagjen e Re në Kaçanik;

- Rehabilitimi i rrugës(me asfalt) "Kemal Thaqi" në fsh. Runjevë;
- Rehabilitimi i rrugës(me asfalt) "Burhan Zeneli" në fsh. Bob;
- Shtrimi me zhavor i rrugës "Razim Hasaj" me gjatësi L=260.40 m;
- Shtrimi me zhavor i rrugës "Brahim Muça" në fsh. Kovaçec;
- Asfaltimi vendkalimeve për këmbësor në afërsi të shkollave;
- Përfundimi i trotuarit në rrugën "Epopeja e UCK-së" në fsh. Kaçanik i Vjetër;
- Shtrimi me zhavorr në rrugën e lagjes "Fuga"-Biqec;

Zgjerimi dhe pastrimi i rrugës "Komandant Bardhi" në fsh. Begracë.

Sektori i Emergjencave

DSHPE – sektori i emergjencave edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të jetë elementi themelor në identifikimin e shkaktarëve të rrezikut, evidentimin e tyre dhe marrjen e masave preventive për zbutjen ose eliminimin e pasojave nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera që mund të rrezikojnë banorët e Komunës sonë.

- Pas shfaqjes së virusit COVID – 19 në Kosovë, Kryetari i Komunës z. Besim Ilazi me dt. 13.03.2020 merr VENDIM për formimin e Shtabit Emergjent për Parandalimin e virusit COVID-19 në Komunën e Kaçanikut.
- VENDIM për aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente Lokale (QOEL) me rastin e shfaqjes së pandemisë të virusit COVID 19.
- Janë dërguar raporte mbi situatën nga Covid-19 në Qendrën Operative Emergjente Regjionale në Gjilan .
- Rregullisht kemi marr pjesë në takime të shtabit emergjent për parandalimin e virusit COVID-19.


- Është bërë pastrimi dhe rregullimi i shtratit të përroskave për eliminimin e rrezikut nga vërshimet.
- Janë ndërtuar mure mbrojtëse në për sanimin e rrezikut nga shembja e dheut.
- Është mbajtur takim me Grupin punues të Ministrisë së Punëve të Brendshme me qëllim të ruajtjes së kapaciteteve reaguese.
- Me dt. 18.04.2020 për shkak të shembjes së dheut dhe rrezikimit të banorëve në kompleksin banesor "Panorama është bërë evakuimi dhe akomodimi i 3 familjeve.
- Është bërë Monitorimi i projektit të ndërtimit të 11 shtëpive të ndërtuara nga Shoqata humanitare "Jetimat e Ballkanit" në participim me Komunën e Kaçanikut.

Nr	Lloji i intervenimit	Janar	shkurt	mars	pri ll	maj	qershor	ko rr.	gusht	shtat	tet or	nën tor	dhjetor	Gjithsej
1	Zjarre	7	12	29	35	7	4	10	8	2	1	6	4	125
2	Intervim teknik	1				1		1	3	1	1		2	10
3	Shërbi me							1						1

4	Akside nt K.	1	1	1	1	4
5	Vërshi me					
6	Alarm i rrejshë m			1	1	1
Gjithsej 8 13 29 35 9 4 13 11 3 3 6 8 142						

- Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit ka intervenuar në 142 raste prej të cilave 125 kanë qenë zjarre (malore, fushore, objekte banimi, objekte ndihmëse, objekte biznesi, oxhaqe, objekte publike, objekte industriale, pajisje elektrike) si dhe intervenime tjera të paraqitura në tabelë.

Tabela: Kategorizimi dhe intervenimi i zjarreve sipas muajve gjatë vitit 2020



DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Shqyrtimi i kërkesave, mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti komunës

Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët dhe për vendosjen e kërkesave të tyre qytetarët janë informuar me kohë, gjithashtu kjo drejtori është angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve me mjete nga buxheti komunës dhe projektet e Subvencionimit të fermërve nga projektet e MBPZHR.

Gjatë periudhës janar-dhjetor janë organizuar 2 trajnime në lëminë e bujqësisë, ku kanë prezentuar 28 fermerë.

Fermerët janë mbështetur duke i ofruar ndihmë në plotësimin e aplikacioneve me dokumentacione përcjellëse, gjatë aplikimit për subvencione dhe grante të ofruara nga MBPZHR. Gjithashtu fermerët janë mbështetur edhe nga projektet e DBZHRP-së

* Nga projekti mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m² kanë përfituar 171 fermerë, shuma e mjeteve 59,632.66€, 20 % participim i fermerëve 10,773.00€.

Këtë vit kemi realizuar edhe projektet për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatin Soponicë Lagja Provoli -fshati Nikaj dhe ndërtimi i kanalit të ujitjes nga seperacioni deri në Kaçanik (2280 metra gjatësi), vlera e projektit 48,338.80 €

Vlen për të theksuar se gjatë këtij viti kemi pasur dëme në kultura bujqësore lavërtarë dhe pemëtarë, nga faktorët klimatik (era dhe breshëri), gjithashtu dëme kemi pasur në blegtori dhe bletari nga kafshët e egra (ujku dhe ariu). Kemi dy raste të djegës së shtallave nga zjarri, si pasojë e rrymës. Për të gjitha rastet, fermerët kanë adresuar kërkesa në drejtori, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara, për të gjitha kërkesat kemi bërë vlerësime, kemi hartuar raporte me shkrim të cilat i kemi dërguar në MBPZHRP-së (30 kërkesa). Për kërkesat e vlerësuara nga faktorët klimatik (era dhe breshëri) nga MBPZHR kemi

premtime se fermerët do të kompensohen 25% të vlerës së demit të vlerësuar nga komisioni.

Për shkak të pandemisë këtë vit organizimet për vizita tek fermerët kanë qenë më të vogla krahasuar me vitet paraprake. Këshilla dhe udhëzime fermerëve u kemi dhënë nëpërmjet telefonit, varësisht prej kërkesave dhe nevojave të fermerëve.

Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 12 kërkesa, prej të cilave janë të miratuara 10, të refuzuara 1, në proces për shqyrtim janë 1.

Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është 11.180 m². Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej 8.836.25€.

Me kërkesë të palëve janë lëshuar 68 vërtetime lidhur me numrin e koshereve me bletë që posedojnë bletarët, për aplikim në subvencionet e MBZHRP, dhe 2 vërtetime të fermerëve si dëshmi që merren me bujqësi, janë inkasuar 700'00€

Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale

Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike për temat e shtjelluara nga trajnimet e organizuara gjatë vitit 2020, 2 trajnime gjithsej 28 fermerë. Trajnimet janë organizuar me këto tema, të cekuara me numër pjesëmarrësve siç vijon:

1. Marrja e mostrave të dheut, komentimi i rezultateve dhe rekomandimi për dozat e plehrit të plehrave (12);
2. Komentimi i rezultateve të analizave të mostrave të dheut (tokës) dhe rekomandimi i përdorimit të dozave të plehrave minerale (16).

Bashkëpunimi me MBPZHR dhe OJQ- ve

Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria e BZHRP-së ka bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë Zhvillimit Rural lidhur me organizimin e trajnimeve në fushën e bujqësisë.

Bashkëpunimi me MBPZHR-së gjithashtu ka qenë në implementimin e projekteve të Ministrisë BPZHR siç janë: projektet për subvencionim të fermerëve për lopë qumështore, kafshë të imëta (dele, dhi), bletë, projektet për subvencionimin e mbjelljeve pranverore, vjeshtore, subvencionimin e kulturave perimore, pemëtare dhe në projekte për aplikim në grande. Të gjithë fermerëve të cilët kanë qenë të interesuar për aplikim, i është ofruar ndihmë në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar, për aplikim në subvencionet dhe grandet që ka ofruar MBPZHR. Të gjitha aplikacionet e fermerëve për subvencione janë pranuar në zyrën e DBZHRP-së, të cilat të kompletuara janë dorëzuar në MBPZHR.

Nga projektet e MBPZHR për subvencionim, në komunën tonë kanë aplikuar 379 fermerë, të cilët janë subvencionuar.

Organizimi në mbrojtjen e pyjeve nga prerja ilegale

Rojet e pyllit dhe stafi i sektorit të pylltarisë, janë angazhuar për pengimin e dëmtimit të pyjeve nga prerësit dhe transportuesit ilegal të masës drusore.

-Për periudhën janar-dhjetor janë konfiskuar 128.09m³, nga kjo sasi e masës drusore të konfiskuar 11.90m³, me vendim Gjykata Themelore dega në Kaçanik, ka vendosur që masën drusore të sekuestruar të cekur më lartë t'iu kthehen pronarëve. Sasia e masës drusore që gjendet në Autoparkun e SH.I.L-së është 116.19m³, apo shprehur në metër hapësinor 166.09 (mh) prej kësaj mase drusore 50%, sipas kontratës i takojnë Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SHIL) ndërsa pjesa prej 50% e masës drusore të konfiskuar do të ndahen shkollave.

-Janar- nëntor janë ngritur 183 fletëparaqitje, prej tyre për kundërvajtje 168 dhe 15 për vepër penale.

Gjithashtu për mbajtjen në kontroll e gjendjes së pyjeve, përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta: Komunë, Polici, Gjykatë dhe roje të pyllit, kemi organizuar takime të përbashkëta, me qëllim të ndikimit në pengimin e prerjeve ilegale të pyjeve.

Monitorimi i operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore

Shfrytëzimi i ngastrave të caktuara për prerje sipas planit menaxhimit, shitja me tenderë ngastrave, janë realizuar mjete në shumë prej 36,697.00 € dhe shitja në cung (prerje sanitare) janë realizuar mjete në shumë prej 351.50€. Nga mjetet e realizuara 30% e mjeteve kthehen në buxhet komunës 70% e mjeteve në APK-së.

Kemi pyllëzuar 10 ha sipërfaqe me fidanë të pishës dhe bagremit.

Pranimi dhe vendosja e kërkesave të pronarëve për pyjet private

Janë pranuar 183 kërkesa për prerje në pyjet private të cilat janë aprovuar, Nga kërkesat e aprovuara janë vulosur 4510.46 m³, masë drusore për djegie dhe 302.30m³ trupa teknik, të lejuar për prerje nga APK-ës, për vitin 2020. Të hyrat nga taksat për shërbime në pyjet private janë realizuar 10.95.18 €, të cilat janë derdhur në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës.